

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.12/2018, “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E BRENDSHME”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është të japë një kontribut në përmbushjen e objektivit të qeverisë shqiptare dhe në veçanti të Ministrisë së Brendshme, në krijimin e institucioneve të forta, me profesionistë me integritet.

Vlerësimi i punonjësve, në veçanti i atyre të Policisë së Shtetit, është domosdoshmëri në kuadrin edhe të hapave të hedhura nga reforma në drejtësi dhe specifikisht të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm dhe përfshirjen e Policisë së Shtetit në hetimet ndaj veprave penale.

Procesi i vlerësimit kalimtar bazohet në problemet e identifikuar nga një analizë e detajuar e situatës aktuale në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kjo analizë mundësoi përcaktimin e objektivave specifike, si dhe identifikimin e nevojave për ndryshime ligjore, strukturore dhe procedurale për kryerjen e kontrollit të pasurisë, të figurës dhe aftësive profesionale.

Nëpërmjet këtij procesi synohet të garantohet zbatimi i parimit të integritetit, rritja e profesionalizmit dhe garantimi i një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar kështu institucione të forta dhe të besueshme, me profesionistë me integritet.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, synohet që të ulen kostot e procesit, të shpejtohet koha e shqyrtimit të rasteve individuale dhe të garantohet një standard uniform vlerësimi në fazën e dytë dhe të tretë pa prekur paanshmërinë, pavarësinë, objektivitetin dhe përputhjen e procesit të vlerësimit me parametrat e procesit të rregullt ligjor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2019, për Ministrinë e Brendshme, por është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe atë të Ministrisë së Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mekanizmi i parashikuar në ligjin ekzistues parashikon ngritjen e një serie organesh për vlerësimin kalimtar të punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Brendshme. Sipas këtij modeli “ujëvarë”, vlerësimi kryhet në tri faza, ku në çdo fazë vlerësohen afërsisht 300, 3 000 dhe 9 000 punonjës. Numri i anëtarëve të komisioneve vlerësimit dhe sekretariateve teknike mbështetëse është parashikuar të jetë 30, 90 dhe 270.

Kjo skemë ka disa avantazhe dhe disavantazhe. Nga njëra anë garanton pavarësi, paanshmëri dhe pronësi të procesit të vlerësimit nga vetë strukturat, ndërsa nga ana tjetër kërkon impenjim domethënës të burimeve materiale dhe atyre njerëzore. Këto dy disavantazhe, pra fakti që kërkohej impenjim i konsiderueshëm i burimeve njerëzore të vetë strukturave, duke pasur parasysh se plot 240 punonjës të nivelit të lartë dhe të mesëm duhet të shpërndahen nga detyrat e tyre funksionale dhe të kryejnë procesin e vlerësimit dhe sidomos aspekti financiar, ku sipas parashikimeve procesi i vlerësimit do të kushtojë rreth 300 milionë lekë ose rreth 3 milionë dollarë.

Në këto kushte, duke pasur parasysh se vetë elementi financiar ishte një nga arsyet që solli vonesa në implementimin e procesit, Ministria e Brendshme, pas një analize të thellë dhe shumëplanëshe propozon një mekanizëm të ri për vlerësimin, i cili mund të arrijë po të njëjtat objektiva, pra të pavarësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të procesit, me më pak kosto për buxhetin e shtetit.

Sipas parashikimeve të këtij projektligji, propozohen dy ndryshime thelbësore, pa prekur substancën e kriterëve të vlerësimit apo të procedurës së ndjekur. Kriteret ngelen po ato, pra vlerësimi i figurës, i pasurisë dhe i profesionalizmit, siç ngelet po e njëjtë edhe procedura e vlerësimit.

Ndryshimi i parë thelbësor është që propozohet që punonjësit e SHÇBA-së të kalojnë të gjithë vlerësimin në fazën parë. Sot ligji në fuqi parashikon që vetëm

Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdiri, drejtorët dhe shefat e sektorëve e kalonin vlerësimin në fazën e parë. Vlerësimi i fazës së parë kryhet nga një komision i jashtëm me 15 anëtarë, i asistuar nga një sekretariat teknik me po 15 anëtarë.

Ndryshimi i dytë thelbësor qëndron në faktin se propozohet që të jetë SHÇBA-ja ajo që do të kryejë vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës në fazën e dytë dhe të tretë, pra punonjësit e nivelit të mesëm drejtues dhe të atyre të nivelit bazë.

Kjo zgjidhje ka disa avantazhe të dukshme.

Së pari, ka një impakt të ndjeshëm mbi buxhetin e parashikuar. Ngarkimi i SHÇBA-së me vlerësimin e punonjësve në fazën e dytë dhe të tretë, pra rreth 12 000 punonjës, i kursen buxhetit të shtetit rreth 260 milionë lekë, duke minimizuar kostot shtesë.

Së dyti, garanton të njëjtin të standard për të gjithë procesin. Duke pasur parasysh se vetë punonjësit e SHÇBA-së do t'i nënshtrohen të njëjtit proces në fazë të parë dhe i njëjti standard do të përcillet përgjatë gjithë procesit në fazat e tjera.

Së treti, garanton të njëjtën pavarësi dhe paanshmëri, sa kohë nuk ndryshojnë as kriteret as procedurat e vlerësimit.

Së katërti, shkurton kohën e vlerësimeve individuale, sa kohë një pjesë e madhe e informacioneve për punonjësit e Policisë apo Gardës gjenden në arkivat e vetë SHÇBA-së si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit, pa harruar rolin e vetë SHÇBA-së në proceset e pajisjes me certifikatë sigurie.

Projektligji nuk cenon fazën e parë të vlerësimit. Në këtë fazë, Komisioni i Jashtëm do të vlerësojë punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe të gjithë punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar përputhje të neneve 78, 81, dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, si dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 10 nene.

Neni 1 parashikon një përkufizim të ri të termit “Organe të vlerësimit”, duke hequr nga ky përkufizim komisionin qendror dhe komisionin vendor, që ishin përgjegjës për fazën e dytë e të tretë, dhe duke futur në vend të tyre Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Hiqet, gjithashtu, koncepti i trupës së posaçme të vlerësimit, sa kohë ishte një koncept i lidhur me mekanizmin e parashikuar për fazën e dytë dhe të tretë. Në momentin që propozohet ndryshimi i organeve nuk ka më logjikë ekzistenca e këtyre trupave.

Neni 2, ndryshon nenin 5, të ligjit, dhe saktëson se organet e vlerësimit janë vetëm Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe SHÇBA-ja, duke saktësuar edhe mënyrën e organizimit të këtij komisioni, duke hequr referencat që i bëheshin komisioneve të fazës së dytë dhe të tretë.

Neni 3, ndryshon nenin 6, të ligjit, dhe saktëson dy ndryshimet thelbësore të argumentuara më sipër, pra kalimin në vlerësimin në fazë të parë të të gjithë punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe ngarkimin e SHÇBA-së me vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, që do të kalojnë vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë.

Neni 4, ndryshon nenin 13, të ligjit, dhe vendos një afat kohor për funksionimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit deri në përfundim të fazës së parë, pra vlerësimit të pozicioneve drejtuese të Policisë së Shtetit, gradave të larta të Gardës së Republikës, dhe të gjithë punonjësve të SHÇBA-së.

Neni 5 shfuqizon nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 të këtij ligji. Këto janë nenet që rregullonin përzgjedhjen, organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe sekretariateve të fazës së dytë dhe të tretë.

Neni 6 ndryshon nenin 24, të ligjit, duke saktësuar organizimin përkatës vetëm për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, sa kohë propozohet ndryshimi i autoritetit përgjegjës për vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë.

Neni 7, ndryshon nenin 29, të ligjit, pasi me ndryshimin e autoritetit përgjegjës për vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë, nuk ekziston më nevoja që anëtarët e këtyre të kthehen në pozicionet e mëparshme.

Neni 8, propozon rregullime në gjithë tekstin e projektligjit.

Fjalët "... komisionet e vlerësimit ..." zëvendësohen me "Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit" dhe fjalët "... sekretariateve teknike ..." zëvendësohen me "... sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ...".

Gjithashtu, propozohen ndryshime në pjesën e procedurës së vlerësimit për të saktësuar se SHÇBA-ja do të ketë të njëjtat kompetenca dhe do të ndjekë të njëjtën procedurë që ndjek Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Neni 9, shfuqizon nenin 68 të ligjit, duke eliminuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e procesit. Procesi filloi me gati 9 muaj vonesë dhe nuk mendohet se ky afat mund të respektohet.

Neni 10, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit apo atë të Ministrisë së Brendshme.

KËSHILLI I MINISTRAVE